



07Nr.441 datë 17.07.2026

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 20 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.01/2018 për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor, si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor dhe Statutit të Komunës së Suharekës, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis nxjerr këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Për: Draft Planin Rregullues të Hollësishëm për Zonën Ekonomike në Duhël

Datë: 24.07.2026 Ora:11:00

Vendi: Shtëpia e Kulturës, Suharekë

17-07-2026

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
PRIMLJENO-RECEIVED	
Njësia e J. Org. Un.	Shënjestra Prillog Number
07	26
Vlera Vrednost Valtre	33082

Komuna e Suharekës fton dhe njofton qytetarët, pronarët e pronave të përfshira brenda zonës së planit, përfaqësuesit e bizneseve, institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile, ekspertët e fushës, trupat konsultative dhe të gjitha palët e tjera të interesuara se do të mbahet prezantimi publik i Draft Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Ekonomike në Duhël, Komuna e Suharekë.

Qëllimi i prezantimit publik është informimi i publikut dhe sigurimi i pjesëmarrjes transparente dhe gjithëpërfshirëse në procesin e hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm. Të gjithë pjesëmarrësit do të kenë mundësi të parashtrojnë pyetje dhe të japin mendime, propozime, sugjerime dhe vërejtje lidhur me zgjidhjet e propozuara në Draft Plan.

Komuna e Suharekës inkurajon veçanërisht pronarët e pronave brenda zonës së përfshirë, operatorët ekonomikë dhe banorët e zonës përreth që të marrin pjesë në prezantim dhe të kontribuojnë në procesin e planifikimit.

Draft Planin Rregullues të Hollësishëm për Zonën Ekonomike në Duhël do të jetë i qasshëm edhe në faqen zyrtare të Komunës së Suharekës: <https://suhareke.rks-gov.net/>.

Për informata shtesë, palët e interesuara mund t'i drejtohen Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim dhe Mjedis të Komunës së Suharekës.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim dhe Mjedis të Komunës së Suharekës
Drejtuesi i Drejtorisë:
Visar KUÇI

